



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Sesioni pranveror

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion
Mbledhja nr. 16/2010

Prishtinë më 20. 04. 2010, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

**I mbledhjes së Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport
dhe Telekomunikacion**

Në mbledhje morën pjesë: Myzejene Selmani - kryetare, Ethem Çeku, Sala Berisha – Shala, Zef Morina, Qamile Morina, Fatmir Rexhepi, Mufëra Şinik, Nerxhivane Dauti dhe Kaqusha Jashari.

Mungoi: Mursel Haljilji.

Pjesëmarrës të tjerë: Selvie Çeku dhe Bashkim Navakazi - MTI, Besim Zeqiri – ICO, Visar Ramaj – KDI dhe Ibrahim Krasniqi - konsulent.

Stafi Mbështetës: Hasan Tahiri, Advije Morina, Armend Ademaj, Besim Haliti dhe Nuriye Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Myzejene Selmani, kryetare.

Në këtë mbledhje u propozua ky

R e n d d i t e

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të 30. 03. 2010 dhe të 13. 04. 2010,
3. Shqyrtimi i Projektligjit për përcaktimin e të drejtave dhe për mbrojtjen e topografisë së qarqeve të integruara nr. 03/L-165,
4. Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja – Propozoi që pas pikës së tretë të shtohen edhe dy pika të tjera të rendit të ditës:

4. *Shqyrtimi i emërimit të kandidatit për anëtar të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit;*
5. *Shqyrtimi i emërimit të kandidatit për anëtar të Komisionit Kosovar të Konkurrencës.*

Rendi i ditës i plotësuar me këtë propozim, u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të 30. 03. 2010 dhe të 13. 04. 2010

Procesverbalet e mbledhjeve të 30. 03. 2010 dhe të 13. 04. 2010 u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për përcaktimin e të drejtave dhe për mbrojtjen e topografisë së qarqeve të integruara nr. 03/L-165

Kryetarja – I njoftoi deputetët se Raportin e Projektligjit për përcaktimin e të drejtave dhe për mbrojtjen e topografisë së qarqeve të integruara nr. 03/L-165, do ta paraqesë kryesuesi i grupit të punës, Fatmir Rexhepi.

Fatmir Rexhepi – E paraqiti Raportin e grupit të punës për Projektligjin për përcaktimin e të drejtave dhe për mbrojtjen e topografisë së qarqeve të integruara nr. 03/L-165, me 7 (shtatë) amendamentet e propozuara për shqyrtim dhe për miratim, si në vijim: amendamenti 1 - në nenin 1, shtohet paragrafi 2; amendamenti 2 - ka ndërhyrje tekniko – juridike në paragrafët 3 dhe 4 të nenit 5; amendamenti 3 - ndryshohet paragrafi 2 i nenit 7; amendamenti 4 - pas paragrafit 3.6, shtohet paragrafi 3.7 i nenit 9; amendamenti 5 – ka ndërhyrje, ndryshohet titulli i nenit 12; amendamenti 6 – ka ndërhyrje tekniko-juridike në nenin 13 dhe amendamenti 7 – ka ndërhyrje tekniko-juridike në nenin 14.

Pas debatit Komisioni nxori këtë

Përfundim

I- Pas debatit për secilin nen të Projektligjit dhe të secilit amendament veç e veç, Komisioni i miratoi shtatë amendamente së bashku me Projektligjin për përcaktimin e të drejtave dhe për mbrojtjen e topografisë së qarqeve të integruara nr. 03/L-165.

II- Amendamentet janë pjesë e këtij procesverbali.

4. Emërimi i anëtarit të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP)

Kryetarja – I njoftoi anëtarët e Komisionit se duhet të shqyrtohet dhe të rekomandohet në bazë të Përfundimit të Kryesisë së Kuvendit nr. 03-P-212, të 13. 04. 2010, për emërimin e anëtarit të Bordit të AKP-së, në të cilin i propozuar i Qeverisë është Naser Osmani. Njëkohësisht këtij Përfundimi i është bashkangjitur CV-ja e të propozuarit.

Sala Berisha – Shala – Theksoi se nuk do t'i japë ngjyrim politik këtij debati. Pyeti a është i kundërligjshëm posti i dyfishtë i z. Osmani. Është deputet i Kuvendit dhe njëkohësisht propozohet anëtar i një bordi të caktuar, në këtë rast të AKP-së?

Kryetarja – Sqaroi se mund të jetë, për shkak se edhe kryetari i Partisë Liberale Serbe (SLS), është edhe deputet, edhe anëtar i Bordi të AKP-së.

Pas debatit Komisioni me 8 (tetë) vota” për” dhe 1 (një) kundër, nxori këtë:

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të Republikës së Kosovës ta mbështetë dhe ta miratojë Propozimvendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 4/117, të 30 marsit 2010, për emërimin e kandidatit Naser Osmani anëtar të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP).

5. Emërimi i anëtarit të Komisionit Kosovar të Konkurrencës (KKK)

Kryetarja – I njoftoi anëtarët e Komisionit se duhet të shqyrtohet dhe të rekomandohet në bazë të Përfundimit të Kryesisë së Kuvendit nr. 03-P-203, i 23. 03. 2010, për emërimin e anëtarit të KKK-së, në të cilin i propozuar i Qeverisë është Gani Asllani. Këtij Përfundimi i është bashkëngjitur CV-ja e të propozuarit.

Sala Berisha – Shala – Kur është zgjedhur Bordi i kësaj Agjencie të pavarur i kemi pasur 10 të propozuar. Komisioni pas intervistimit i propozoi 5 kandidatë për miratim në seancë plenare, kurse tash e kemi vetëm një kandidatë të propozuar.

Pas debatit, Komisioni me 8 (tetë) vota” për” dhe 1 (një) kundër, e nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të Republikës së Kosovës ta mbështetë dhe ta miratojë Propozimvendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 4/114, të 12 marsit 2010, për emërimin e kandidatit Gani Asllani anëtar të Komisionit Kosovar të Konkurrencës (KKK).

6. Të ndryshme

i) Shqyrtimi i raporteve vjetore të agjencive të pavarura

Kryetarja – Kërkoj nga Komisioni ta planifikojë shqyrtimin e raporteve vjetore të agjencive të pavarura, siç janë: Raporti vjetor i AKP-së; i KPMM-së; i ZRRE-së; i KKK – së dhe AAC - së.

Pas debatit Komisioni nxori këtë

Konkluzion

Në mbledhjen e radhës të shqyrtohen Raporti i AKP-së dhe Raporti i ZRRE-së dhe të ftohen përfaqësuesit e tyre.

ii) Procedimi i projektligjeve

Kryetarja – Theksoi se në bazë të konkluzioneve që kanë dalë nga mbledhja e fundit më Kryetarin e Kuvendit është rekomanduar që projektligjet e energjisë të shqyrtohen dhe të procedohen në pako për miratim në seancë plenare.

Pas debatit Komisioni e nxori këtë

Konkluzion

Formohet Grupi i punës për shqyrtimin e projektligjeve të energjisë në këtë përbërje: Ethem Çeku - raportues, Sala Berisha – Shala dhe Kaqusha Jashari.

iii) Monitorimi i zbatimit të ligjeve

Kryetarja – Propozoi që në 6-mujorin e parë nga Komisioni të mbikëqyret së paku zbatimi i një ligji. E propozoi edhe Ligjin për naftën dhe derivatet e naftës.

Zef Morina – Propozoi të mbikëqyret zbatimi i Ligjit të telekomunikacionit nr. 2002/7.

Pas debatit Komisioni e nxori këtë

Konkluzion

Miratohen propozimet për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për naftën dhe derivatet e naftës nr. 2004/5 dhe të Ligjit të telekomunikacionit nr. 2002/7.

iv) Mbledhja e radhës

Kryetarja – Propozoi që në mbledhjen e radhës të shqyrtohen Raporti i AKP-së, Raporti i ZRRE-së, Projektligji për inspektimin e tregut nr. L-181 dhe të miratohet Raporti i Projektligjit për miniera dhe minerale nr. L-163.

Pas debatit Komisioni e nxori këtë

Konkluzion

Në mbledhjen e radhës të shqyrtohen 1. Raporti i AKP-së, 2. Raporti i ZRRE-së, 3. Projektligji për inspektimin e tregut nr. L-181 dhe 4. të miratohet Raporti i Projektligjit të minierave dhe të mineraleve nr. L-163.

Mbledhja përfundoi në orën 12: 00.

E përgatiti:

Njësia e mbështetjes së Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Myzejene Selmani